



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AKP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit kemi vërejtur se procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ishte përcjellë me mangësi. Mangësitë e identifikuara janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. Prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 4,190,798€. Prej tyre janë realizuar 4,926,016€ gjatë vitit 2022. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 249 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 230 të punësuar edhe tetë anëtar të Bordit. Gjatë vitit 2022 nuk kishte punësime të reja. Kemi testuar 70 mostra (teste substanciale dhe të pajtueshmërisë për transaksion) në vlerë prej 111,603€.

Çështja A1 - Parregullsi në evidencat e vajtje ardhjes së punonjësve

Gjetja Bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publikë sipas nenit 4.1 “Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten”, dhe nenit 8 .1 respektim i orarit te punës “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik”.

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve nga 74 mostra të audituara, në 13 raste kemi vërejtur se nuk kishte evidenca të rregullta në sistemin elektronik të vijueshmërisë hyrje/dalje. Prej tyre në gjashtë (6) raste kishte mungesë evidentimi nga një muaj deri në një vit.

Mungesa e evidencave në sistemin elektronik të hyrje/daljeve ka ardhur si rezultat i kontrollit dhe monitorimit të dobët nga menaxhmenti.

Ndikimi Mos evidentimi i stafit në sistemin e vijueshmërisë në punë rrit rrezikun e prezencës së tyre në vendin e punës.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë kontrole dhe monitorim të evidentimit të stafit në sistemin elektronik të vijueshmërisë hyrje/dalje me qëllim të mbarëvajtjes së vijueshmërisë në punë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Tejkallim i afateve të parapara ligjore në funksionin e detyrës për zëvendësuesit

Gjetja Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik, Neni 32, pika 4, përcakton se " Përjashtimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj.

Në një rast tek pozita e "Koordinatorës të koordinimit rajonal", zëvendësimi kishte zgjatur për një periudhë më të gjatë se 12 muaj brenda 2 viteve.

Mbajtja e pozitave të lira me zëvendësues ka ardhur si rezultat i procesit të rristrukturimit dhe riorganizimit të AKP-së.

Ndikimi Mbajtja e pozitave përtej afatit ligjor mund të ndikoj në realizimin e plotë të detyrave.

Rekomandimi A2 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që janë respektuar kërkesat ligjore në rastet e mbulimit të pozitave me zëvendësime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Transferimi i punonjësve brenda organizatës jo në përputhje me kërkesat ligjore

Gjetja Ligji nr. 06/l - 114 për zyrtarët publikë, nënkapitulli 2 transferimi në shërbimin civil, neni 52 Transferimi i përkohshëm 1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës. Rregullorja (MPB) nr. 02/2020 për planin e personelit përkatës neni 4.5.3. Numrin e pozitave të lira për të cilat do të shpallet konkurrimi për çdo kategori dhe klasë dhe periudhat e plotësimit të tyre, duke përfshirë pranimin, lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritjen në detyrë, dhe neni 4.7 Planet vjetore individuale mund të ndryshojnë gjatë vitit për t'u adaptuar me situata të caktuara të personelit të institucionit përkatës. Në çdo rast të nevojës së ndryshimit të tyre, ndryshimet përkatëse duhet të pranohen nga DMZP, i cili bën njëkohësisht edhe reflektimin në planin vjetor të përgjithshëm të ndryshimit përkatës.

AKP nuk kishte arritur të planifikoj pozitat e lira, apo plotësimin e këtyre pozitave duke përfshirë, pranimin, lëvizjen dhe ngritjen në detyrë. Plani i zhvillimit të personelit nuk ishte ndryshuar as gjatë vitit. Si pasojë AKP është përball me transferim të stafit në mënyrë të parregullt. Si rezultat i testimit të mostrave/ transfereve ka rezultuar se:

Në nëntë (9) raste, transferimi i zyrtarëve brenda institucionit, ka kaluar afatin ligjor prej 6 muajve brenda 2 viteve. Nëse marrim për bazë vitin 2021/2022 periudha e angazhimit ka zgjatë nga 9-18 muaj.

Në katër (4) raste vërehet se transferimi i punonjësve nuk ishte bërë brenda të njëjtës kategori. Në këto raste zyrtaret kanë përfituar paga më të larta duke mos respektuar kërkesën ligjore që nëpunësit civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të të njëjtës kategori.

Kjo për shkak se AKP nuk ka përfshirë në planin e zhvillimit të personelit pozitat e lira dhe i njëjti plan nuk është përditësuar bazuar në nevojat me të cilat përballlet AKP.

Ndikimi Lëvizjet e stafit nga një departament në tjetrin, vështirësojnë menaxhimin e resurseve njerëzore dhe vazhdimin normal të procesit të punës në interes të institucionet.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve me qëllim të mbarëvajtjes së institucionit dhe zhvillimit të aktiviteteve normale në të gjitha njësitë, duhet të sigurojë që të bëhet rishikimi dhe përditësimi i planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte 1,267,204€, prej tyre ishin shpenzuar 883,787€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, qiraja për ndërtesa, qiraja për përdorime tjera hapësinore, shpenzimet për informim publik dhe mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve etj. Kemi testuar gjashtë mostra për teste substanciale në vlerë 26,150€, dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve

Gjetja

Sipas nenit 41.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Prosesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve".

Në procedurën e prokurimit "Ofrimi i shërbimeve për marketing, dizajn, video-produksion dhe publikim në portale" në vlerë prej 84,460€, vlerësimi i tenderëve ishte kryer 42 ditë pas hapjes së ofertave, dhe për këtë nuk kishte kërkesë nga komisioni për afat shtesë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontrolleve të pamjaftueshme gjatë vlerësimit të ofertave.

Ndikimi

Krijimi i vonesave në vlerësimin e tenderëve përveç se paraqet shkelje të rregullave, e njëjta ndikon në vonesën e lidhjes së kontratave dhe rrjedhimisht shtyrjen e marrjes së mallrave/shërbimeve.

Rekomandimi A3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave realizohet brenda afateve të përcaktuara kohore, duke mundësuar që mallrat/shërbimet të pranohen në kohën e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A4 - Nxjerrja e urdhërblërjeve pas pranimit të faturës

Gjetja	<p>Rregulla financiare nr. 01/2013- Shpenzimi i parave publike, neni 22- procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë.</p> <p>Gjatë testimeve të pagesave në AKP, kemi vërejtur që për dy pagesa në vlerë prej 46,823€, urdhër blerjet ishin proceduar pas pranimit të faturës. Pagesat kanë të bëjnë me furnizim me pajisje të teknologjisë informative.</p> <p>Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontroleve nga zyra e prokurimit me rastin e procedimit të urdhërblërjes.</p>
Ndikimi	<p>Pranimi i mallrave dhe shërbimeve si dhe faturës para se të procedohet urdhër blerja, përveç se paraqet shmangie të procedurave të përcaktuara me rregullat financiare njëkohësisht e rritë rrezikun që të pranohen mallra apo shërbime jo në pajtim me kushtet e kontraktuara.</p>
Rekomandimi A4	<p>Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që të nxjerrën urdhërblerjet para se të pranohen mallrat dhe faturat në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blerjet e pa kontrolluara.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 81,055€, pasurive jokapitale është 130,919€, si dhe e stoqeve 8,999€. Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 58,205€, gjithashtu kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Mos funksionimi i sistemit "e-pasuria"

- Gjetja** Sipas rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare neni 6, paragrafi 3 "pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet, në sistemin "e-pasuria".
- AKP gjatë vitit 2022 nuk kishte arritur që të funksionalizojë sistemin e-pasuria. Megjithatë AKP aplikon një regjistër të brendshëm për menaxhimin e pasurisë jokapitale dhe pasuritë regjistrohen në këtë regjistër.
- Edhe gjatë vitit 2022, AKP ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme që të barten shënimet në sistemin "E-Pasuria", me qëllim të funksionalizimit të këtij sistemi, mirëpo kërkesa ka rezultuar pa sukses.
- Ndikimi** Sistemi jo funksional i e-pasurisë sipas kërkesave rregullative për menaxhim të pasurive, ndikon në mos-përmbushjen e kërkesave ligjore për regjistrimin e pasurisë. Më tej, mos funksionimi i sistemit e-pasuria rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë dhe mos shpalosjes të drejtë të tyre në pasqyrat vjetore financiare.
- Rekomandimi B2** Bordi i Drejtorëve duhet të marrë veprime të nevojshme dhe të vazhdueshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

AKP ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe tre auditor. NjAB kishte hartuar planin e punës duke u bazuar në strategjinë e saj. Për vitin 2022 NjAB kishte planifikuar dhe përfunduar tetë auditime. NjAB gjatë vitit 2022 kishte realizuar edhe një auditim me kërkesë. NjAB ka mbuluar kryesisht periudhën 2022.

Çështja A5 - Funksionimi i Komitetit të Auditimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit

Gjetja	<p>Ligjin Nr. 06/L-021, për Kontrollin e brendshëm të financave publike, neni 20, pika 3, thekson se “Komiteti i auditimit përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë, ku dy të tretat (2/3) janë të jashtëm nga fusha përkatëse e auditimit, ndërsa pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik”.</p> <p>Komiteti i auditimit në AKP përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët janë anëtar të Bordit të Drejtorëve dhe nuk ishte në harmoni me kërkesat e ligjit pasi në përbërjen e tij nuk ka dy të tretat e anëtarëve të jashtëm.</p> <p>Kjo situatë kishte ndodh si rezultat i natyrës specifike të Agjencisë.</p>
Ndikimi	<p>Përbërja e Komitetit të Auditimit jo në përputhje me legjislacionin në fuqi mund të ndikoj në performancën e realizimit të detyrave të Komitetit.</p>
Rekomandimi A5	<p>Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë së emërimi i anëtarëve të Komitetit të Auditimit të bëhet konform kërkesave të përcaktuar me ligjin për Kontrollin e brendshëm të financave publike.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	5,533,002	6,237,675	5,944,598	6,531,932	6,832,923
Grante Qeveritare - Buxheti	5,533,002	6,237,675	5,944,598	6,531,932	6,832,923

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 704,673€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor dhe pesë vendimeve të qeverisë: me nr.03/110, nr.05/110 dhe nr.04/115, për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore.

Në vitin 2022 AKP-ja ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar ose 5,944,598€ me një zvogëlim prej 9% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	5,533,002	6,237,675	5,944,598	6,531,932	6,832,923
Pagat dhe mëditjet	4,190,798	4,930,471	4,926,016	5,348,022	5,348,346
Mallrat dhe shërbimet	1,169,204	1,144,204	883,787	1,079,742	1,367,926
Komunalitë	98,000	123,000	100,680	61,419	50,105
Subvencionet dhe transferet	5,000	5,000	0	0	33,066
Investimet Kapitale	70,000	35,000	34,115	42,749	33,480

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje me buxhetin fillestar ishte rritur për 739,673€. Ndryshimet kanë ndodhur me dy vendime të Qeverisë nr. 05/110 të datës 29.11.2022 (rritje për 315,068€) dhe nr. 04/115 të datës 23.12.2022 (rritje për 424,605€) ;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 25,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendimin të Qeverisë nr.03/110 të datës 29.11.2022
 - Buxheti final për shërbime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 25,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendim të Qeverisë nr.03/110 të datës 29.11.2022; dhe
 - Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 35,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2022.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga AKP-ja në vitin 2022 ishin në vlerë 1,220€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e mbeturinave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	1,220		
Të hyrat jo tatimore	0	0	1,220		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të AKP-së ka rezultuar në tre rekomandime kryesore. AKP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, një rekomandim është zbatuar dhe dy rekomandime nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën katër (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Bordi i Drejtorëve të AKP-së me qëllim të mbarëvajtjes së institucionit dhe zhvillimit të aktiviteteve normale të të gjitha njësive, duhet të siguroj që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me transferimet e përkohshme të stafit si dhe lidhjen dhe zbatueshmërinë e kontratave.	Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se nuk janë respektuar kërkesat ligjore në lidhje me transferimet e përkohshme të stafit.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Çështjet e përbashkëta	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të rishikoj procedurat të cilat ndikojnë në funksionimin e kontrolleve të brendshme për të identifikuar arsyet e mos zbatimit të kërkesave të kontratës dhe të siguroj që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.	Gjatë vitit 2022 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të siguroj vazhdimin e bashkëpunimit aktiv me MPBAP, për eliminimin e mangësive në sistemin e-pasuria, përfshirë edhe bartjen e shënimeve të pasurive jo kapitale.	Nga mostrat e testuar kemi vërejtur se ende nuk ka filluar përdorim i sistemit e-pasuria.	Nuk ka filluar zbatimin


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Valbona Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letërkonfirmim

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
II	
Nr. Br:	2185
No. No. No.:	
Nr. IFr. Br. Sr. No. Pg.:	
Data: 22 JUN 2023	Date: 22 JUN 2023
Përbërës / Pristina	

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
 KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
 PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: **Vlora Spanca**
 Auditore e Përgjithshme
 Zyra Kombëtare e Auditimit


REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO			
Zyra Kombëtare e Auditimit			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
23.06.2023			
Org. Qend. / Org. Unit.	Shifra / Klasi / Kod. / Case. Code.	Pr. Pr. / Pr. Pr. / Pr. Pr. / Pr. Pr.	Ngj. / Nr. / No. / No.
05	47	1040	1

E nderuar znj. Spanca,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,


Arben Limani
 Drejt. Menaxhues
 Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
 Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.